



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1121/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lorenc Marleku kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Klinë, paraqitur kundër komisionerëve të qendrave të vendvotimeve, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lorenc Marleku kandidat për kuvendin komunal në Klinë nga radhët e subjektit politik AAK .

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Lorenc Marleku anëtarë për asamble komunale nga subjekti politik AAK dega në Klinë, i cili konsideron se ju kanë marrë votat nga komisioneri i partisë së tij me numër 08/02 dhe 08/03 .Kam dyshimin e bazuar që nuk më janë dalë votat të cilat më kanë premtuar votuesit dhe këtë ankesë e bëj për shkak të presionit të tjereve e cila ka ndodhur mbrenda subjektit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Lorenc Marleku nga komuna e Klinës PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1121/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.